



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 9, datë 28 .02. 2013

PËR

“MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES ME QIRA TË OBJEKTIT “REPARTI TERMIK MEKANIK DHE INSTRUMENTAL ” ME SIPËRFAQE TOTALE 26.857 M², NJËSI E UZINËS SË PJESËVE TË NDËRRIMIT TË AUTOMJETEVE”.

Në mbështetje të nenit 32, shkronja “e”, ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); neneve 20, 22, 23, të ligjit nr.7582, datë 13.07.1992 për “Ndërmarrjet shtetërore” (i ndryshuar); udhëzimit nr.6, datë 3.9.1992 për “Zbatimin e ligjit nr.7582, datë 13.07.1992 për “Ndërmarrjet shtetërore”; pikës 1 të VKM-së nr.378, datë 12.08.1999 për “Kalimin e të drejtës së përfaqësuesit të pronarit për disa objekte pronë publike, organeve të qeverisjes vendore” (i ndryshuar); VKM-së nr.529, datë 08.06.2011 për “Përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” dhe udhëzimit nr.906, datë 21.11.2011 për “Zbatimin e vendimit të këshillit të Ministrave nr.529, datë 08.06.2011 për “Përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Miratimin në parim të dhënies me qira të objektit “Reparti Termik Mekanik dhe Instrumental” me sipërfaqe totale 26.857 m², njësi e Uzinës së Pjesëve të Ndërrimit të Automjeteve.
2. Afati i dhënies me qira të jetë për një periudhë 5-vjeçare.
3. Ky proces të kryhet nëpërmjet procedurave të konkurimit publik dhe elementëve të tij në mbështetje të VKM-së nr. 529, datë 08.06.2011 për “Përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.
4. Ngarkohet Ndërmarrja UPNA, Drejtoria e Financës dhe Drejtoria Juridike, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

Niazi KOSOVRASTI